



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:325892
Datë: 22.01.2025
Numri i dokumentit: 06744165

C.nr.1133/24

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridiko-civile të paditëses L.B nga Rahoveci, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Z.H nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me çështjen kontestimore padi për kompensim për orët për punë gjatë fundjavës, vlera e kontestit e pa përcaktuar, më datë 22.01.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SË ËSHTË TËRHEQUR padia e paditëses L.B nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me çështjen kontestimore padi për kompensim për orët për punë gjatë fundjavës.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja L.B nga Rahoveci, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, me datë 12.09.2024 ka paraqitur në Gjykatë padi për Kompensim për orët gjatë fundjavës.

Gjykata duke vepruar lidhur me këtë çështje, ka marrë Aktvendim C.nr.1133/24, i datës 03.12.2024, me të cilin e ka ftuar paditësen L.B, që në afatin prej 3 ditëve ta përmirësojë dhe plotësojë padinë, si dhe të paguaj taksën gjyqësore në shumën prej 20 (njëzetë) euro.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me datë 24.12.2024 përmes parashtresës e ka njoftuar gjykatën që i njëjti nuk mund ta paguaj taksën pasi që është në një udhëtim zyrtar jashtë vendit.

Në shkresat e lëndës vërehet se përfaqësuesi i paditësit aktvendimin C.nr.1133/24, i datës 03.12.2024, e ka pranuar me datë 16.12.2024, ndërsa deri më tani gjykata nuk ka pranuar ndonjë shkresë nga pala paditëse për përmirësimin dhe plotësimin e padisë, e as pagesën e taksës gjyqësore, përveç parashtresës se gjendet në udhëtim zyrtarë, andaj gjykata vlerëson që pasi i njëjti ka mundur ta dorëzojë parashtresën i njëjti njëkohësisht ka mundur ta paguaj edhe taksën gjyqësore.

Duke marrë parasysh faktin se as pas aktvendimit të ndërmarrë nga gjykata, paditësi nuk bërë pagesën e taksës, gjykata vendosi si në dispozitiv, e në pajtim me dispozitat e nenit 253 pika 4. Dhe 5. të Ligjit nr.03/1-006 për Procedurën Kontestimore, në të cilin nen thuhet se: “ 253.4 Paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkangjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar. 51 253.5 Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 253 pika 4 dhe 5 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.1133/24, më datën 22.01.2025

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.